

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “Bicikleta N'Uje” sh.p.k.

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

Kreu I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Bazuar në Kushtetutë dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, ligjin nr.9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” dhe në ligjin nr. 9723, date 3.5.2007 për Q.K.B (Qendra Kombëtare e Biznesit):

1. Sot më date 26/12/2024 une,

- **Blerti Vejuka** shtetas Shqiptar, lindur me 16/09/1999 , Shkoder, banues Shkoder, identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **J90916095V** vendosa per te krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**Bicikleta N'Uje**” SH.P.K.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Dhenie me qera dhe hua e pajisjeve te transportit te ujit
- Guide turistike ne Liqenin e Shkodres

Neni 3

Kohëzgjatja

Jetëgjatësia e shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

Neni 4:

Selia

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: **SHIROKE, Prane dy molave ne liqenin e Shkodres, Shkoder .**

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:

vejukablerti@gmail.com

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **1 400 000** Lekë.
- (2) Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
 - a. Ortaku I vetem Z Blerti Vejuka : Zotëruese i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përbën **100%** të kapitalit themeltar të shoqërisë (1.400.000 Leke)

Kontributi I ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë(pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi I kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën mase ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi I kapitalit

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Cdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Kreu III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarrës

Ortaku i shoqërisë është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i shoqërisë është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;
- c) Emerimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së verimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë;
- m) Ceshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Cdo ndryshim i statutit rregjistrohet sipas ligjit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 9

Administrimi

- (1)Ortakët emërojnë një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2)Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3)Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:

Z. Blerti Vejuka , shtetas Shqiptar, lindur me 16/09/1999, banues Shkoder,identifikuar me numrin e kartes se identitetit nr **J90916095V** .

Neni 10

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë,duke zbatuar politikat tragtare,të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të shoqërisë;
- Përgatisin dhe nënshkruajë bilancin vjetor,bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe,së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve,l paraqesin keto dokumente perpara asamblese së përgjithshme për miratim;

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

- Krijonë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat,që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë,sig parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare,dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratores janë të detyruar të thërrasin asamblene e përgjithshme në rastet kur:
- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare,rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.
- Shoqëria propozon të shesë apo të disponojë një mënyrë tjetër active,të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë,që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara..

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se 1 administrator ,ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në cdo kohë me shumicë të zakonshme.Paditë që lidhen me shpqrblimin e administratorit ,në bazë të mardhënieve kontraktore me shoqërinë,rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 11

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht,ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve,për shkelje të ligjeve,për shkelje të statutit,apo për faje te kryera gjatë administrimit të shoqërisë.Pasojat e marrëveshjeve te pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë,i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bërë marrveshjen,për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht,sipas rastit,pasojat përkatëse

Perveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë,sipas neneve 14,15,17 e 18 të ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”,administrator detyrohet;

1.

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

- a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesimin dhe interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçante ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendimi;
- d) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, present apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim apo mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlersimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barren e proves për të vertetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë por pa u kufizuar në to, administrator është i detyruar ti dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme;

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interest apo dividendë;
- c) U shpërndanë aktivet shoqërisë;
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkatur shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

Kreu IV VITI FINANCIAR-EKSPERTET

Neni 12 Viti financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht viti i parë fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13 Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar, që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve, për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendore që ka.

KREU V PRISHJA-RIORGANIZIMI I SHOQËRISE

Neni 14 Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) Me vendim të asamblesë së ortakëve;
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
- e) Me vendim të gjyqates;

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë, mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”

AKT THEMELIMI DHE STATUT “Bicikleta N'Uje ” SHPK

Prishja e shoqërive tregtare ka sipasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga oratkët.

Nëse oratkët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brënda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar, mund ti drejtohet gjykates, për të caktuar një likuidues.

Neni 15

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Neni 16

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 17

Mosmarrvëshjet

Për mosmarrvëshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrvëshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Z. Blerti Vejuka


(nënshkrimi)